



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 30/4-2022 i Regjistrimit Themeltar
Nr. 30/4 i Vendimit**

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Sokol SADUSHI - Kryesues
Sokol NGRESI - Anëtar
Gentian MEDJA - Anëtar

sot më datë 17.01.2023, mori në shqyrtim kërkesën administrative nr. 30-2022, që u përket palëve:

KËRKUES: Vladimir Lulaj, përfaqësuar nga Avokat Ervin Grabova

OBJEKTI: Shqyrtimi i kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe tejzgjatjen e gjykimit të kërkesë padisë me objekt *“shmang’ja e diskriminimit antiligjor dhe dhënia e pensionit të pleqërisë dhe pensionit suplementar sipas bazës së vlerësuar reale, me vjetërsi pune 44 vjet dhe vjetërsi shërbimi ushtarak 23 vite, sipas përkufizimit të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”*.

BAZA LIGJORE: Neni 6/1 i Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, Kodi i Procedurës Civile, nenet 130, 131, 145, 147, 171/a, 181, 285/a, 302, 303, 308/2, 309, 310/3, 314, 399/1- 399/12, 443, 444, 450, 451, 451/a, 459, 474, ligji nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” neni 151, 159, ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” neni 5, 27, 28, 38, 39.

Në çështjen administrative:

PADITËS: Vladimir Lulaj

PADITUR: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë
Instituti i Sigurimeve Shoqërore
Qendra e Personel Rekrutimit

OBJEKTI: Shmangia e diskriminimit antiligjor dhe dhënia e pensionit të pleqërisë dhe pensionit suplementar sipas bazës së vlerësuar reale, me vjetërsi pune 44 vjet dhe vjetërsi shërbimi ushtarak 23 vite.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. Sokol Ngresi dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes.

1. Nga aktet rezulton se pala kërkuese Vladimir Lulaj, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padinë me objekt “*shmangia e diskriminimit antiligjor dhe dhënia e pensionit të pleqërisë dhe pensionit suplementar sipas bazës së vlerësuar reale, me vjetërsi pune 44 vjet dhe vjetërsi shërbimi ushtarak 23 vite*”.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 2237, datë 11.06.2018, ka vendosur: “*Pranimin e pjesshëm të padisë...*”.

3. Ndaj vendimit të sipërcituar, është bërë ankim. Aktualisht çështja objekt gjykimi ndodhet pranë Gjykatës Administrative të Apelit dhe është në pritje të gjykimit.

4. Me kërkesën objekt gjykimi, kërkuesi Vladimir Lulaj, përfaqësuar nga Avokat Ervin Grabova ka pretenduar shkeljen e afatit të arsyeshëm në Gjykatën Administrative të Apelit, me këto shkaqe:

- Për 75 muaj rresht pensioni im i pleqërisë dhe ai suplementar, grabitet në masën 17.100 lekë në muaj, për shkak të segmenteve të korruptuar në ISSH, DRSSH, QPR të Ministrisë së Mbrotjtjes, kancelarit dhe gjyqtarëve të posaçëm.
- Gjykatat nuk janë për të shkelur afatet prekluzivë, ose të arsyeshëm të gjykimit, por të nderojnë, respektojnë e zbatojnë ligjin dhe detyrimet e tyre zyrtare.
- Vendimi nr. 2237, datë 11.06.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë konstatohet i formës së prerë, jo vetëm për shkak se i padituri nuk ka ushtruar ankim brenda afatit por nuk lejohet as ankim, si dhe ankimi i rezervohet vetëm paditësit i cili ka hequr dorë nga vazhdimi i gjykimit.
- Kërkesë padia është paraqitur më 5 janar 2018 dhe ka përfunduar me vendimin nr. 2237, datë 11.06.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë më datë 29.06.2018, për shkak se nuk është paraqitur asnjë ankim brenda afatit 15 ditor. Pra ka 4 vjet e 5 muaj që mbahet antiligjërisht nga Gjykata Administrative e Apelit si dhe 77 muaj që i grabiten 19 mijë lekë çdo muaj.
- Kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit, me kryesues relatore Altina Nasufi, në seancën gjyqësore datë 28.04.2022, ora 08:50 AM, me 1210 ditë vonesë nga afati prekluzivë 30 ditë u parashikuar nga nenit 48/2 i ligjit nr. 49/2012.
- Gjyqtarja relatore duhet të kishte vendosur mospranimin e ankimit, por në fakt vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore datë 14.06.2022, ora 09:30. Ky qëndrim ka të bëjë me përtacinë 53 mujore të ndihmësve ligjor, të cilët duke mos hulumtuar dosjen si dhe parashtruar keqinformim se ankimi është bërë gjoja në afat, de facto bashkëpunojnë prej 4 vitesh në shitjen e drejtësisë me “oktapodin DRSSH Tiranë”.
- Konstatohet se shkelja e afatit të arsyeshëm të gjykimit, me strategia antiligjor është shtyrë për 4 vjet e 5 muaj, ka vendosur ta zhvilloj në seancë gjyqësore në datë 05.12.2022. Në

këto kushte kërkojë konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe vendimi përfundimtar ti përcillet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vlerësuar faktin se vonesat janë shkaktuar me dashje dhe paramendim..

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) konstaton se kërkesa është paraqitur nga një subjekt i legjitimuar. Kërkuesi Vladimir Lulaj, rezulton të jenë në cilësinë e palës paditëse në procesin gjyqësor për të cilin është regjistruar ankimi me nr. regjistri themeltar 31138-03194-86-2018, datë 25.07.2018 në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kërkesa është në kompetencën e këtij Kolegji, sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Civile, pasi, përmes saj, kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit. Kërkesa i plotëson elementët e parashikuar në nenin 399/5, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile si dhe është e shoqëruar me të gjitha aktet e tjera të nevojshme, të përcaktuar në nenin 399/5, pika 2, të Kodit të Procedurës Civile.

7. Kolegji vlerëson se parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm ka një rëndësi themelore për gjykimin civil/administrativ, pasi përbën dhe një nga elementët e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Respektimit të këtij parimi përcakton në mënyrë të ndjeshme dhe efektivitetin e procesit gjyqësor. (*Shih vendimin H. kundër Francës, datë 24.10.1989 të GJEDNJ*)

8. Kolegjin çmon të theksojë praktikën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), e cila ka përcaktuar se periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor. (*shih vendimin Qufaj kundër Shqipërisë; Vendimin Scopelliti kundër Italisë, datë 23.11.1993 të GJEDNJ*). Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjes.

9. Në vijim, të jurisprudencës së konsoliduar GJEDNJ ka identifikuar disa elemente përbërëse të këtij standardi. Në referim të saj, rezulton se në përlllogaritjen e afatit të arsyeshëm merren në konsideratë faktorë të ndryshëm, të tilla si : kompleksiteti i çështjes; sjellja e palëve ndërgjyqëse; sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative. (*Shih vendimin Buchholz kundër Republikës Federale Gjermane datë 06.05.1981 dhe Bjeliç kundër Sllovenisë ap. nr. 50719\06, datë 18.10.2012. të GJEDNJ*)

10. Kolegji vlerëson se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes, merr në konsideratë të gjithë faktorët dhe elementet që kanë të bëjnë me çështjen, natyrën e interesave të përfshira në të, rëndësinë e fakteve, rëndësinë e zgjidhjes ligjore, numri i personave të akuzuar dhe i dëshmitarëve, elementet ndërkombëtarë, lidhja e çështjes me çështje të tjera dhe ndërhyrja e personave të tjerë në procedure. (*Shih vendimin Trggiani kundër Italisë datë 19.02.1991; Manieri kundër Italisë dt. 27.02.1992, Stefancic kundër Sllovenisë, datë 25.10.2012 të GJEDNJ*)

11. Përsa i përket sjelljes së palëve, Kolegji çmon se ky kriter lidhet me mënyrën se si ato janë sjellë në proces, apo ndaj procedimit, dilijencën e treguar prej tyre për përfundimin e procesit, pengesat që ato kanë krijuar dhe faktorë të tjerë që janë të lidhur me veprimet ose mosveprimet e tyre që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Megjithatë, kjo duhet vlerësuar rast pas rasti, pasi një person nuk është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet proceduese në mënyrë aktive për të përshpejtuar procedurat gjyqësore që çojnë në dënimin e tij. (*shih vendimin Eckkle kundër Republikës Federale Gjermane, dt. 15.07.1982 të GJEDNJ*)

12. Kolegji vlerëson se, përse i përket sjelljes së autoriteteve për vlerësimin e kohëzgjatjes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, GJEDNJ ka vlerësuar se vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të merren parasysh. Këto vonesa mund të shkaktohen ose nga autoritetet gjyqësore ose nga autoritetet administrative. Shkaqe të kësaj natyre në jurisprudencën e GJEDNJ janë vënë në dukje si p.sh.: bashkimi i gabuar i disa çështjeve që ka shkaktuar vonesa të panevojshme, shtyrjet e pabazuara në ligj të seancave gjyqësore, pezullimi i kundërligjshëm i procesit gjyqësor, vonesat nga ana e agjencive publike ligjzbatuese të shtetit në dorëzimin e provave të kërkuara nga gjykata, transferimi i çështjeve penale nga një gjykatë në tjetrën, mbajtja e seancave të apelimeve. (*Shih vendimin Eëing kundër Mbretërisë së Bashkuar*)

13. Në çështjen objekt gjykimi, Kolegji konstaton se në momentin e regjistrimit të kërkesës në Gjykatën e Lartë, çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Apelit, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Civile (1 vit), pasi nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit dhe deri në paraqitjen e kësaj kërkesë ka kaluar një kohë prej 3 vjet.

14. Duke marrë në vlerësim standardet e përcaktuar nga jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me afatin arsyeshëm, nuk rezulton që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar, apo të jetë shtyrë gjykimi për shkak të kërkesave të palës kërkuese. Çështja nuk paraqitet shumë komplekse nga natyra e saj, pasi ka të bëjë me të drejtat subjektive, të cilat pretendohen se janë cenuar nga veprimet e paligjshme të palës së paditur, organ i administratës publike. Nga ana tjetër, nuk konstatohet ndonjë sjelle e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit.

15. Kolegji vlerëson se në lidhje me mosveprimin e gjykatës që nga momenti i depozitimit të ankimit e deri në datën që kërkuësja ka paraqitur kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të shqyrtimit, duhet mbajtur në konsideratë ngarkesa totale individuale e gjyqtarit relator si dhe ngarkesa e këtij të fundit në raport me gjyqtarët e tjerë. Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, gjyqtari relator, pasi u njoh me kërkesën, ka depozituar më datë 28.02.2020 mendim me shkrim në të cilën ka parashtruar se në lidhje me këtë çështje është ndjekur radha si të gjitha çështjet, kjo çështje ka pasur dy relatorë të tjetër më parë dhe vetëm në datë 17.12.2021 është caktuar si relatore gjyqtarja Altina Nasufi. Gjyqtarja ka theksuar se pavarësisht kësaj, kjo çështje është shpallur në seancë gjyqësore që në datë 28.04.2022 dhe së fundmi kjo çështje është caktuar për t’u zhvilluar në datë 05.12.2022.

16. Kolegji vlerëson të theksojë se vonesa e gjatë në shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete objekt gjykimi, është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Përbën një fakt të njohur botërisht se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh në Republikën e Shqipërisë. Ky proces natyrshëm ka krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore. Këto vështirësi janë proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme që padyshim krijon procesi i reformës.

17. Komisioni i Venecias ka theksuar se reforma në drejtësi, procesi i verifikimit të gjyqtarëve/prokurorëve në Shqipëri, ishte e domosdoshme, edhe nëse do të sillte pasoja të paparashikuara. Përveç aspekteve të padyshimta pozitive mbi cilësinë e gjyqësorit në planin afatgjatë, në një periudhë afatshkurtër procesi i verifikimit ndikon në numrin e gjyqtarëve aktiv në sistem duke shkaktuar problem të përkohshme praktike derisa të bëhet zëvendësimi i tyre (*Shih European Commission for Democracy through laë (Venice Commision) Albania) opinion on the appointment of judges to the Constitutional Court*).

18. Kolegji vlerëson se kjo çështje është marrë në shqyrtim dhe është gjykuar në themel. Në kushtet kur çështja e themelit është marrë në shqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit, Kolegji vlerëson se çështja me objekt shqyrtimin e kërkesës së konstatimit e shkeljes së afatit të

arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, tashmë ka mbetur pa objekt. Në këto kushte gjykimi i kësaj kërkesë në Gjykatën e Lartë duhet të pushohet. Kolegji sjell në vëmendje pikën 3 të nenit 399/7 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se “3. Në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës organi që po kryen veprimet, ndërmerr hapat që po kërkohen nga pala, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pushon shqyrtimi i kërkesës.”.

19. Për sa më sipër, Kolegji çmon se duhet të vendoset pushimi i kërkesës pasi çështja është marrë në shqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë bazuar në nenin të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe nenit 399/7 pika 3 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Pushimin e gjykimit të kërkesës.

Tiranë, më 17.01.2023